



RËPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

V E N D I M

Nr. 1403 , datë 27.10.2008

PËR

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.521, DATË 8.8.2007, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PROCEDURAT E BLERJES
NGA MINISTRIA E MBROJTJES TË DISA MALLRAVE TË
PËRJASHTUARA NGA RREGULLAT E PËRGJITHSHME
TË PROKURIMIT PUBLIK"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 11, të nenit 14, të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000, "Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit dhe drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të shkronjave "a" e "b", të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Në vendimin nr.521, datë 8.8.2007, të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Miratimin e rregullores për procedurat e prokurimit, që do të zbatohen nga Ministria e Mbrojtjes, për prokurimin e mallrave dhe të shërbimeve, që përjashtohen nga rregullat e përgjithshme të prokurimit publik, sipas shkronjave "a" e "b", të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, përcaktuar në shtojcën, që i bashkëlidhet këtij vendimi."

b) Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Miratimi për prokurimin e armëve, të municioneve apo pajisjeve e materialeve ushtarake, veçmas a si pjesë e një sistemi, që gjykohet se ka ndikim të veçantë në çështjet e mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare, bëhet sipas pikës 15, të nenit 14, të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000, “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.”.

c) Pika 3 shfuqizohet.

ç) Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Analiza, studimi, klasifikimi e vlerësimi i armëve, municioneve apo pajisjeve e materialeve ushtarake, veçmas apo si pjesë e një sistemi, dhe i shërbimeve, të lidhura me to, për të cilat do të zbatohet ky vendim, bëhen nga bordi i modernizimit, i ngritur në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Mënyra e funksionimit dhe përbërja e këtij bordi rregullohen me urdhër të ministrit të Mbrojtjes.”.

2. Për procedurat e blerjes së mallrave dhe shërbimeve, që përjashtohen nga prokurimet publike, të cilat kanë filluar para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, për fazat e mbetura të procesit, të zbatohen rregullat e sipërpërmendura.

3. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Flëtoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI



SALI BERISHA

MINISTRI I MBROJTJES

GAZMEND OKETA



KESHILLI I MINISTRAVE
NR 4242 D. 16. 1999

RREGULLORE

PËR PROCEDURAT QË PËRDOREN NGA MINISTRIA E MBROJTJES PËR PROKURIMIN E DISA MALLRAVE DHE SHERBIMEVE TE PERJASHTUARA NGA RREGULLAT E PËRGJITHSHME TE PROKURIMIT PUBLIK.

KREU I

PËRKUFIZIME

Për qëllim të kësaj rregulloreje termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Procedurat përzgjedhëse të prokurimit" janë procedurat e ndërmarra nga autoriteti kontraktor për përzgjedhjen e fituesve sipas rregullave të përcaktuara në këtë rregullore. ✓
2. "Fondet publike", që më poshtë do të quhet "fondet" janë çdo vlerë monetare e buxhetit të shtetit, e përcaktuar për përdorim në prokurimet për blerjen e mallrave dhe shërbimeve. ✓
3. "Kontratat për shërbime" janë kontratat që kanë objekt kryerjen e shërbimeve. Kontratat, që kanë objekt shërbimet, por që përfshijnë edhe punime të lidhura në mënyrë dytësore me objektin kryesor të kontratës, vlerësohen "kontrata për shërbime". ✓
4. "Kontratë furnizimi", janë kontratat që kanë objekt prokurimin, prokurimin me pjesë, ose me këste dhe qiranë, me ose pa mundësi prokurimi, të mallrave. Një kontratë që ka objekt furnizimin me mallrave dhe që përfshin në mënyrë dytësore edhe vendosjen e instalimin, vlerësohet si «Kontratë Furnizimi, në se vlera e mallrave e tejkalon vlerën e vendosjes apo instalimit.
5. « Prokurim për mallra dhe shërbimet » është prokurimi i cili realizohet nëpërmjet procedurës përzgjedhëse të kufizuar, me negociim të drejtpërdrejtë dhe prokurimit shtet me shtet, të cilat realizohen me shtetet anëtare të NATO-s, strukturat e tyre të vartësisë, ose me subjektet përkatëse, që kanë kontrata me vendet e NATO-s.
6. "Mallra" janë armët, municionet, materialet luftarake dhe sistemet, te cilat u shërbejnë qëllimeve të mirfillta ushtarake.

N
n
d
n
n
n

l.

7. "Kontraktues", "Furnizues", ose "Sigurues shërbimi" është operatori ekonomik, i cili mund të jete nje subjekt ose nje shtet.
8. "Ofertues" është operatori ekonomik, ose nje strukturë shtetërore e vendeve, anetare të NATO-s, që paraqet një ofertë në një prokurim të kategorizuar sipas procedures se përshkruar në këtë rregullore.
9. "Kandidat" është operatori ekonomik, që kërkon të ftohet në një nga procedurat e përcaktuara në këtë rregullore.
10. "Autoritet kontraktor" është Ministri i Mbrojtjes, ose një person i autorizuar prej tij.
11. "E drejta ekskluzive" është një e drejtë, që i garantohet autoritetit kontraktor, për të zgjedhur një operator ekonomik të vetëm, ose një shtet anëtar të NATO-s, për shkak të ekskluzivitetit, ose të të drejtës së autorit që ai ka mbi mallin apo shërbimin.
12. "Procedurë e kufizuar" është procedura përmes së cilës mund të marrin pjesë vetëm operatorët ekonomikë të përzgjedhur nga autoriteti kontraktor.
13. "Procedurë me negociim të drejtpërdrejtë" është procedura përmes së cilës autoriteti kontraktor e përzgjedh vetë operatorin ekonomik dhe negocion kushtet e kontratës me të.
14. "Procedura e prokurimit shtet me shtet" është procedura përmes të cilës Ministria e Mbrojtjes blen direkt nga një ministri homologe ose strukturë e vartësisë së saj, ose e autorizon atë për të kryer procedurat e prokurimit në interes të autoritetit kontraktor nëpërmjet marrëveshjeve teknike ose nëpërmjet një kërkesë të vecantë për prokurim.
15. "Kërkesë e vecantë" është kërkesa, që i dërgohet një shteti për realizimin e procedurës së prokurimit shtet me shtet, në rastin kur nuk ka një marrëveshje teknike.
16. "Kërkesa për Cmim dhe Disponueshmëri" është dokumenti me anë të të cilit Ministria e Mbrojtjes kërkon, nëpërmjet ministrive homologe, strukturave të tyre të vartësisë, ose operatorëve ekonomike që operojnë me to, testimin e tregut dhe disponueshmërinë e tyre. Disponueshmeria dhe cmim i ofruar nga subjekti ekonomik mund te konsiderohet oferte. Në kërkesën për cmim dhe disponueshmëri mund të mos të deklarohet fondi limit.

17. "Kërkesa për prokurim" është dokumenti përmes të cilit Ministria e Mbrojtjes i kërkon një ministrie homologe, ose strukture në vartësi të saj për të paraqitur ofertën e tyre.
18. "Pranimi i Ofertës" është dokumenti përmes të cilit në prokurimin shtet me shtet palët pranojnë kushtet përfundimtare të prokurimit, në të cilat përfshihet sasia, cmimi, vlefata dhe kushtet teknike. Në varësi të vecorive të shteteve ajo mund të jetë e formuluar në mënyrë të ndryshme.
19. "Komunikimi me shkrim" është çdo shprehje që përbëhet nga fjalë ose shifra, të cilat mund të lexohen, kopjohen dhe komunikohen, përfshirë edhe informacionet, që transmetohen ose ruhen në mënyrë elektronike.
20. "Rregullat e prokurimit" janë ato të shprehura në këtë rregullore.
21. "Dokumentet e tenderit" janë dokumentet, që autoriteti kontraktor vë në dispozicion të kandidatëve dhe ofertuesve të mundshëm për përgatitjen e ofertave, sipas përcaktimeve të bëra në këtë rregullore.
22. "Kërkese operationale" është kërkesa e cila përshkruan kërkesën operationale dhe kërkesat kryesore teknike të mallit, pajisjes, sistemit e teknikës.
23. "Program i Përbashkët", është programi që integron kërkesat operationale të pajisjeve, armatimit, teknikës dhe sistemeve të hatuara nga strukturat që gjenerojnë këtë kërkesë.
24. "Armatim" konsiderohet kombinimi i një ose më shumë armëve të tipave dhe llojeve të njëjta, ose të ndryshme, të mbështetura nga sistemet e komandimit e drejtimit, pajisjet, materialet dhe shërbimet ushtarake që shërbejnë për funksionimin e tyre në mënyrë efikase, vecas, ose të integruara. Ato mund të jenë në funksion të plotësimit të misionit të Forcave Tokësore, Ajrore dhe Detare.
25. "Municion" është malli, i cili në përbërje të tij ka ngarkesë eksplozive, piroteknike, lëndë initiale ose elementë të tjerë kimikë e bakteriologjikë me qëllim përdorimi, në lloje të ndryshme të operationeve ushtarake, stërvitje, trajnim dhe në rast ceremonie. Në këtë kategori përfshihet edhe tipi i municionit për qëllim shkatërrimi.
26. "Materiale luftarake" janë materialet që nevojiten për plotësimin e detyrave operationale të trupave të luftimit, mbështetjes të

luftimit dhe mbështetjes logjistike, të cilat konsiderohen pjesë e kompleteve vepruese të armatimit, municionit, sistemeve dhe teknikes luftarake.

27. "Shërbime" që lidhen me armët, municionet dhe materialet luftarake, janë ato shërbime të cilat konsiderohen pjesë e pandarë e ndërtimit, funksionimit dhe mirëmbajtjes së sistemeve të armatimit, të pajisjeve dhe të teknikës ushtarake luftarake. Ato mund të përfshihen në të njëjtën kontratë ose në një kontratë të vecantë, në mbështetje të kontratës së parë.
28. "Kontratat me ndikim të vecantë në çështjet e mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare", janë ato kontrata, nëpërmjet të cilave sigurohet prokurimi i mallrave dhe shërbimeve që lidhen me sistemet e zbulimit, në nivel kombëtar, të hapësirës tokësore, detare dhe ajrore, me teknikën dhe sistemet e reagimit të Forcave Tokësore, Detare e Ajrore. Pjesë e kësaj kategorie të jenë edhe kontratat e sistemit të sigurisë në nivelin e Forcave të Armatosura, i cili ndërthuret me elementë të klasifikimit të informacionit në nivel kombëtar.
29. "Proces i prokurimeve ushtarake" është procesi, i cili përfshin gjenerimin e kërkesës operacionale, hartimin e propozimit teknik ose të detyrës së projektimit, realizimin e procedurës së prokurimit, zbatimit të kontratës, operimit të mallit apo sistemit dhe menaxhimit të tij gjatë gjithë ciklit jetësor të mallit, deri në daljen e tij nga kompletimi i forcave të armatosura.

KREU II

ORGANIZIMI I PROKURIMIT TË MALLRAVE DHE SHËRBIMEVE USHTARAKE

1. Strukturat përgjegjëse të procesit të prokurimeve ushtarake

Strukturat përgjegjëse për realizimin e procesit të prokurimit të armëve, municioneve, materialeve luftarake, sistemeve e të shërbimeve, të lidhura me to dhe të mallrave e shërbimeve për të cilat autoriteti kontraktor gjykon se botimi i të dhënave, mund të çënojë interesat thelbësore, të mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare, që përjashtohen nga rregullat e prokurimit publik, janë; autoriteti kontraktor, strukturat e gjenerimit të kërkesave operacionale, bordi i modernizimit, drejtoria e menaxhimit të projekteve të modernizimit, sektorët e menaxhimit të kontratave, komisioni i vlerësimit të ofertave, grupi i negocimit të kontratës dhe strukturat e përdorimit operacional të armeve, municioneve, sistemeve dhe materialeve luftarake.

1.1. "Autoriteti kontraktor" është përgjegjës për prokurimet me fonde publike, të vëna në dispozicion të tij, në përputhje me përcaktimet e këtij Vendimi të Këshillit të Ministrave. Ai raporton në mënyrë të hollësishme, në fund të çdo viti, në Këshillin e Ministrave, për realizimin e procedurave për këto prokurime.

1.2. "Strukturat e gjenerimit të kërkesave operacionale" janë ato struktura ushtarake të përhershme ose të përkohshme, të ngritura enkas, të cilat hartojnë kërkesën operacionale për mallra dhe shërbime, në mbështetje të plotësimit të misionit dhe detyrave kryesore. Në rastin kur struktura të ndryshme kanë kërkesë të ngjashme, kërkesat operacionale integrohen në një program të përbashkët.

1.3. "Bordi i Modernizimit" është strukturë e ngritur pranë Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, i cili funksionon në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave, që miraton këtë rregullore dhe të urdhrit të Ministrit të Mbrojtjes. Ai merr në shqyrtim kërkesat operacionale të hartuara nga strukturat e gjenerimit të kërkesave operacionale, bën studimin dhe klasifikimin mallrave dhe shërbimeve (armeve, municioneve, materialeve luftarake, sistemeve e të shërbimeve, të lidhura me to dhe të shërbimeve për të cilat autoriteti kontraktor gjykon se botimi i të dhënave mund të çënojë interesat thelbësore të sigurisë kombëtare, ose që kanë ndikim të veçantë në çështjet e mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare) që përjashtohen nga procedurat e prokurimit publik. Bordi i Modernizimit vlerëson e miraton, nga ana operacionale dhe funksionale, propozimin teknik të hartuar nga strukturat përgjegjëse.

1.4. "Drejtoria e Menaxhimit të Projekteve të Modernizimit" (DMPM) është struktura që përgjigjet për realizimin dhe administrimin e procesit të prokurimit të mallratve dhe të shërbimeve të përjashtuara nga rregullat e përgjithëshme të prokurimit publik. Njësia e prokurimit, në përbërje të saj, përgjigjet për realizimin e prokurimit vetëm për mallrat dhe shërbimet që janë objekt i kësaj rregulloreje. Ajo vepron në pajtueshmëri me vendimin e Bordit të Modernizimit, kërkesën e drejtuar nga strukturat ushtarake dhe miratimit të autoritetit kontraktor dhe përgatitjes së propozimit teknik.

1.5. "Grupi i vlerësimit të ofertës", është strukturë e përkohshme që ngrihet me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, rast pas rasti, në përshtatshmëri me specifikën e objektit të prokurimit. Në rastet e prokurimit shtet me shtet, roli i grupit të vlerësimit të ofertës mund të kryhet nga DMPM.

1.6. "Grupi i negociimit të kontratës" është strukturë e përkohshme që ngrihet me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, rast pas rasti, në përshtatshmëri me specifikën e objektit të kontratës. Në rastet e

prokurimit shtet me shtet, roli i grupit të vlerësimit të ofertës mund të kryhet nga DMPM.

1.7. "Sektoret e menaxhimit të kontratave" përgjigjen për administrimin e kontratave të lidhura për mallra dhe shërbime, të cilat janë objekt i kësaj rregulloreje dhe për menaxhimin e kontratave kryesore, të sistemeve dhe teknikës të modernizimit të Forcave të Armatosura, procedurat e prokurimit të cilave janë realizuar sipas procedurave të prokurimit publik.

1.8. "Strukturat e përdorimit operacional" janë strukturat të cilat marrin në përdorim mallrat dhe shërbimet e prokuruar sipas përcaktimeve në këtë rregullore.

KREU III

RREGULLAT E PËRGJITHSHME TË PROKURIMIT TË MALLRAVE DHE SHËRBIMEVE USHTARAKE

1. Klasifikimi i Kontratave

Kontrat që lidhen me prokurimin mallrave dhe shërbimeve, sipas përcaktimit të bërë në këtë rregullore, klasifikohen në kontrata shumë vjecare dhe në kontrata një vjecare.

a) Kontrat shumë vjecare janë kontratat, financimi i të cilave shtrihet në më shumë se një vit financiar. Ato mund të jene kontrata shume vjecare të zakonshme dhe kontrata shume vjecare me ndikim të vecantë në çështjet e mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare. Miratimi i kontratave shumevjecare të zakonshme janë në përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, ndërsa kontratat shumëvjecare dhe njëvjecare, me ndikim të vecantë në çështjet e mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare, janë në përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave.

Klasifikimi i kontratave në të tilla, bëhet nga Bordi i Modernizimit.

b) Kontrata një vjecare, janë kontratat të cilat kërkojnë financim vetëm në një vit financiar. Këto kontrata janë përgjegjësi e plotë e autoritetit kontraktor.

2. Llogaritja e vlerës së kontratës

a) Vlera limit e kontratës është shuma totale, e pagueshme, pa TVSH, e llogaritur nga autoriteti kontraktor përpara dërgimit të kërkeses për oferte të ministritë homologe, strukturat e tyre vartese, të vendeve anëtare të NATO-s, ose të subjektet që operojnë me këto vende. Në llogaritjen e vlerës merret parasysh edhe shuma totale, që duhet paguar në rast ripërtëritjeje të kontratës, kur një gjë e tillë është parashikuar si mundësi. Vlera e TVSH-së llogaritet si zë më vete.

TVSH-ja, kur është e zbatueshme i shtohet vlerës së ofertës fituese për llogaritjen e vlerës totale të kontratës, që do të lidhet. Vlera totale e projektit përfshin: vlerën e projektit (mallit), shërbimit që parashikohet të blihet, shpenzimet e transportit, taksat doganore, TVSH, taksat dhe detyrimet të tjera që rrjedhin nga legjislacioni shqiptar, shpenzimet për cështjen e Letrës së Kreditit, etj, sipas vecorisë së kontratës.

- b) Për kontratat shumëvjeçare ose kontratat me mundësi ripërtëritjeje, autoriteti kontraktor duhet të parashikojë rishikimin e vlerës, në përputhje me inflacionin e publikuar. Në rastet e kontratave të furnizimit të mallrave, përmes qirasë fondi limit llogaritet duke përfshirë qiranë apo këstin mujor, shumëzuar me numrin e muajve, gjatë të cilave do të zgjasë kontrata.
- c) Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet të ketë parasysh:
- i) Cmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë autoriteti kontraktor dhe strukturat vartëse të saj
 - ii) Cmimet e kontratave të mëparshme, ose aktuale, të realizuara nga ministritë homologe dhe strukturat e tyre të varësisë të vendeve anëtare të NATO-s, për sisteme të tilla apo të ngjashme;
 - iii) Deklarimet në uebsite të NATO-s, të vendeve anëtare të NATO-s, ose të subjekteve që operojnë me këto vende.
 - iv) Koston dhe disponueshmerine e ministrive homologe, strukturave vartëse të tyre dhe subjekteve që operojnë me to, të ofruara prej tyre,

Cmimet merren në formë krahasimore duke bërë llogaritjet e nevojshme në përshtatshmëri me objektin e prokurimit. Analiza e konostos së armëve, municioneve, pajimeve, pajisjeve ushtarake e materialeve luftarake dhe të shërbimeve të lidhura me to, si dhe produktet e shërbimit, që u shërbejnë qëllimeve të mirëfillta ushtarake, bëhet në bazë të konceptit kosto-efektivitet.

3. Dokumentet e prokurimit

a). Dokumentet standarde të prokurimit

Drejtoria e menaxhimit të projekteve të modernizimit, për realizimin e prokurimit të mallrave, produkteve dhe shërbimeve, që nuk i nënshtrohen Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" (neni 5), përgatit dokumentat standarde të tenderit. Ajo shfrytëzon dokumentat standarde të tenderit të përgatitura nga APP, duke bërë modifikimet e nevojshme, në mbështetje të kriterëve të përcaktuara në këtë rregullore.

Këto dokumenta, përveç të tjerash, domosdoshmerisht të përfshijnë:

- i. Informacion të përgjithshëm
- ii. Informacion specifik, që ka lidhje me objektin e kontratës dhe llojin e procedurës, i cili plotësohet, në çdo rast, nga autoriteti kontraktor.

Dokumentet duhet të jenë gjithmonë në dispozicion të çdo operatori, të cilit i është ofruar kërkesa për pjesëmarrje në tender.

b) Informacioni i përgjithshëm përfshin:

- i. Njoftimin e kontratës;
- ii. Formularin e ftesës për ofertë,
- iii. Udhëzimet për kandidatët/ofertuesit;
- iv. Formularin e ofertës;
- v. Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes;
- vi. Formularin e sigurimit të ofertës;
- vii. Formularin e sigurimit të kontratës;
- viii. Formularin e njoftimit të fituesit;
- ix. Formularin e skualifikimit të ofertuesve/kandidatëve;
- x. Formularin e ankesës;
- xi. Kushtet e përgjithshme dhe kushtet e veçanta të kontratës.

Dokumentat e mesiperme nuk aplikohen në rastin e procedurës së prokurimit "shtet me shtet"

c) Informacioni specifik përfshin:

1. Per kontratat e mallrave:
 - (i) specifikimet teknike;
 - (ii) grafikun e lëvrimit;
 - (iii) kualifikimet e veçanta dhe kriteret e shpalljes së fituesit.
2. Per kontratat e shërbimeve:
 - i) termat e referencës;
 - ii) grafikun e realizimit;
 - iii) kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.

Krahas dokumentacionit të mësipërm, subjekteve pjesëmarrëse mund tu vihet në dispozicion edhe ndonjë informacion tjetër që gjykohet i nevojshëm, në përshtatshmëri me objektin e kontratës. Në çdo rast informacioni që ju jepet opertoreve ekonomike duhet të jetë i njëjtë për të gjithë.

4. Informacioni i përgjithshëm

- a). Njoftimi i Kontrates

Njoftimi i kontratës u bëhet ministrive homologe, strukturave të tyre vartese, të vendeve anëtare të NATO-s ose direkt subjekteve që operojnë me vendet e NATO-s (operatoreve ekonomike), në mënyrë direkte ose nëpërmjet përfaqësuesve të akredituar në RSH. Ajo mund të bëhet nëpërmjet kërkesës për cmim dhe disponueshmëri, ose ftesës për ofertë. Mallrat, produktet dhe shërbimet, që nuk i nënshtrohen Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" (neni 5) dhe të përcaktuara sipas kësaj rregullorje, nuk i nënshtrohen njoftimeve publike.

Njoftimi i kontratës përmban të gjithë informacionin e nevojshëm për t'i lejuar operatorët ekonomik të vendosin, nëse do të marrin pjesë ose jo në procedurat e prokurimit. Ky informacion përfshin emrin dhe adresën e autoritetit kontraktor dhe të personit/ave përgjegjës për procedurën; objektin, referencën e njoftimit dhe procedurën e prokurimit; fondin e përlogaritur dhe kohëzgjatjen e kontratës; një përshkrim të shkurtër të kontratës dhe/ose LOTET, nëse ato përdoren. Nëse procedura e prokurimit do të jete me pjesëmarrjen e disa operatoreve ekonomike, u dergohen kërkesat për kualifikim në lidhje me kapacitetet ligjore, ekonomiko-financiare dhe teknike; kriteret e shpalljes së fituesit; vendin, datën dhe orën për dorëzimin e ofertave dhe hapjen e tyre; gjuhën/gjuhët e ofertave dhe të dokumenteve; informacione të mëtejshme, të vlerësuara të dobishme nga autoriteti kontraktor.

b) Formulari i ftesës për ofertë

Ftesa për ofertë i dërgohet vetëm kandidatëve të përzgjedhur nga autoriteti kontraktor dhe përmban të gjithë informacionin e nevojshëm, në mënyrë që ti lejojë kandidatët e përzgjedhur, të dorëzojnë ofertat e tyre. Ky informacion përfshin: një referencë për njoftimin e kontratës; kriteret e shpalljes së fituesit; vendin; datën dhe orën për dorëzimin e tenderit dhe vendin datën dhe orën për hapjen e ofertës; gjuhën/gjuhët e ofertave dhe dokumentave; ndonjë informacion të mëtejshëm që është konsideruar si i dobishëm nga autoriteti kontraktor.

c) Udhëzimet për kandidatët/ofertuesit

Udhëzimet duhet të përmbajnë të gjithë informacionin e duhur, për përgatitjen e ofertës. Në to shpjegohet se pjesëmarrësit në procedurën e prokurimit duhet të përdorin dokumentet e tenderit, pa bërë asnjë ndryshim. Në udhëzime përcaktohet se, nëse parashikohet një vizitë në terren/objekt, atëherë të gjithë pjesëmarrësit në tender duhet të kenë mundësi të barabarta për të vëzhguar terrenin e punës/ekzekutimit. Gjithashtu, mund të organizohet edhe një konsulte paraprake, ku të gjithë kandidatët të mund të kërkojnë sqarime, për ndonjë paqartësi që u lind gjatë përgatitjes së dokumenteve. Kërkesat për sqarime duhet të paraqiten me shkrim dhe përgjigjet përkatëse të autoritetit kontraktor duhet t'u dërgohen, pa përjashtim, të gjithë operatorëve ekonomikë, që janë përcaktuar nga autoriteti kontraktor. Çdo ndryshim në dokumentet e tenderit duhet t'i bëhet i njohur çdo operatori ekonomik kandidat.

Gjatë përgatitjes së ofertave, kandidatët, ose ofertuesit duhet të përfshijnë të gjitha detyrimet fiskale, që janë në fuqi 28 ditë para hapjes së ofertave, me përjashtim të TVSH-së, e cila do të llogaritet mbi vlerën e ofertës, nëse është e aplikueshme.

d) Formulari i ofertës

Formulari i ofertës përmban vlerën e ofertës dhe konfirmimin e ofertuesit se:

- i) e ka shqyrtuar dhe pranuar përmbajtjen e dokumenteve të tenderit;
- ii) autorizon autoritetin kontraktor të verifikojë informacionin/dokumentet që i bashkëlidhen ofertës;
- iii) do të përmbushë kontratën pa asnjë rezervë ose kufizim, në përputhje me projektin, specifikimet teknike, apo termat e referencës, si dhe me vlerën e deklaruar në ofertë.

Formularit të ofertës i bashkëlidhet lista e çmimeve e detajuar, për elementet përbërës që argumentojnë çmimin e plotë. Ofertuesi duhet të deklarojë se oferta mbetet e vlefshme dhe e pa ndryshuar, minimalisht për 150 ditë nga data e fundit e dorëzimit.

e) Kriteret e përgjithshme të pjesëmarrjes

Ky dokument përmban listën e dokumentacionit, ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, të kërkuar nga autoriteti kontraktor, me të drejtën për të marrë pjesë në procesin e prokurimit.

f) Formulari i sigurimit të ofertës

Ky formular shërben si masë mbrojtëse për autoritetin kontraktor, në rastet e ofertave të papërgjegjshme, apo të tërheqjes së ofertave në mënyrë të njëanshme, pas hapjes së tyre, apo refuzimit të nënshkrimit të kontratës. Sigurimi i ofertës ka formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi, e licencuar nga shteti për të ushtruar këtë veprimtari.

Ofertuesit, ose kandidatët e kualifikuar duhet të paraqesin sigurimin e ofertës, në vlerën 2% të vlerës limit, të përcaktuar në dokumentet e tenderit. Sigurimi i ofertës është i vlefshëm për 150 ditë nga afati përfundimtar për dorëzimin e ofertave. Megjithatë në dokumentet e tenderit mund të parashikohet një periudhë e ndryshme vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës.

Lëshuesi i sigurimit të ofertës duhet të:

- mos vendosë asnjë kusht për pagimin;
- paguajë shumën brenda 15 ditëve nga marrja e kërkesës zyrtare të autoritetit kontraktor.

Autoriteti kontraktor duhet t'ua kthejë apo t'ua lirojë ofertuesve sigurimin e ofertës jo më vonë se 15 ditë nga data e nënshkrimit të

kontratës.

g). Formulari i njoftimit të fituesit

Pas miratimit të klasifikimit përfundimtar nga titullari i autoritetit kontraktor siç parashikohet në këto rregulla, ofertuesi i suksesshëm njoftohet me shkrim për pranimin e ofertës dhe për lidhjen e kontratës. Njoftimi duhet të përmbajë: referencën e procedurës, emrin dhe adresën e saktë të ofertuesit të shpallur fitues; përshkrimin e punëve/mallrave /shërbimeve, që do blihen; kohëzgjatjen e kontratës dhe çmimin/vlerën e kontratës; emrat dhe çmimet/vlerën e ofertuesve të tjerë; kërkesën, që kontrata të nënshkruhet brenda 45 ditëve, në rastin kur është zhvilluar tender i kufizuar ose i drejteperdrejte me subjektin ekonomik, me kusht që të jetë bërë sigurimi i saj.

h). Formulari i kualifikimit të ofertuesve/kandidatëve

Ky dokument përmban shkaqet për të cilat një ofertues apo kandidat nuk mund të kualifikohet në një procedurë prokurimi bazuar në kërkesat e kesaj rregulloreje.

i) Formulari i sigurimit të kontratës

Sigurimi i kontratës garanton autoritetin kontraktor në rastet e shkeljes së kontratës. Para nënshkrimit të kontratës, ofertuesi i përzgjedhur si fitues duhet t'i dorëzojë autoritetit kontraktor një sigurim kontrate prej 10% të vlerës së saj. Sigurimi i kontratës ka formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi, e licencuar nga shteti për të ushtruar këtë veprimtari.

Gjatë ekzekutimit, nëse janë parashikuar pagesa periodike, sipas grafikut të zbatimit të kontratës, kontraktori mund të kërkojë reduktimin e përqindjes së vlerës së sigurimit në mënyrë përpjesëtimore, po jo më pak se 25% të vlerës korresponduese të kontratës.

Nëse ofertuesi i përzgjedhur nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar, të përcaktuar në njoftimin e fituesit, atëherë autoriteti kontraktor konfiskon sigurimin e ofertës dhe lidh kontratën me ofertuesin e renditur të dytë në klasifikimin përfundimtar.

j) Formulari i ankesës

Formulari ankesës u shërben operatorëve të interesuar ekonomikë për dorëzimin e ankesës administrative, për veprimet a mosveprimet e autoritetit kontraktor. Ky formular përmban udhëzimet e nevojshme për plotësimin dhe nënshkrimin e tij.

k) Kushtet e përgjithshme dhe të vecanta të kontratës.

Ky dokument përkufizon tërësinë e punëve që do të kryhen mallrat

apo shërbimet që do të furnizohen, të drejtat dhe detyrimet ndërmjet autoritetit kontraktor dhe kontraktorit, si dhe detyrimet që lidhen me ekzekutimin, mbikëqyrjen dhe administrimin e kontratës.

5. Informacion Specifik

a) Kontratat e mallrave

Kontratat e mallrave duhet të pasqyrojnë specifikimet teknike, sasinë e mallrave, që do të lëvrohet për të plotësuar nevojat e autoritetit kontraktor dhe grafikun e lëvrimit, në të cilin përcaktohet qartë mënyra dhe afatet përfundimtare për lëvrimin e mallrave.

Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin, ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar. Ato janë si më poshtë:

- i) Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen. Ato duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit.
- ii) Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët pjesëmarrës,
- iii) Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar standardeve të NATO-s dhe standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare.
- iv) Per tu garantuar per cilesine, autoriteti kontraktor, mund t'i kerkoje subjeketit ekonomik deshmi te origjinalitetit te mallit, testet perkatese dhe ndonje elemente tjeter te cilin ai e vlereson te nevojshem. Ne raste te vecanta ai mund te kerkoje dhe mostra te mallit, te cilat trajtohen ne konfidencialitet.

b) Kontratat e shërbimeve

Natyra e shërbimeve të kategorizuara sipas pikës 2 të këtij VKM, duhet të shprehet qartë në termat e referencës, ku përfshihen objekti, qëllimi, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do kryhet.

Autoriteti kontraktor mund të kërkojë dëshmi të shërbimeve të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit financiare. Dëshmia e realizimit të suksesshëm të shërbimit duhet të provohet me anë të certifikatave/dëshmimeve ose të dokumenteve të tjera, të lëshuara nga përfituesi i shërbimit, certifikime speciale sipas rendesise dhe specifikes se shërbimit, të cilat mund të jenë të NATO-s dhe organizmave të tjera ndërkombëtare, europiane ose kombëtare.

Për kapacitetet, financiare dhe ekonomike, mund të kërkojë kopje të certifikuar të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse; kopje të deklaratave të xhiros vjetore dhe raportet e

menaxhimit, të certifikuara nga një subjekt i jashtëm auditimi, i licencuar.

Kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe llojet e procedurave. Ato aplikohen vecanërisht në kushtet e zhvillimit të një procedure të kufizuar.

c) Kriteret për vlerësimin e ofertës

Vlerësimi i ofertës bazohet në kriterin e ofertës me përparësi më të madhe ekonomike. Kriteret e vlerësimit të ofertës marrin në konsideratë jo vetëm koston e blerjes, por edhe koston jetesore të pajisjes, teknikes, dhe sistemeve të kategorizuara për qëllime të mirfillta ushtarake. Pjesë e kriterëve të vlerësimit është plotësimi i kërkesave operacionale, cmimi dhe kriteret tjera të vlerësimit të ofertës, në përshtatshmëri me vecoritë e objektit të prokurimit. Synimi i vlerësimit të ofertës është efektiviteti maksimal në raport me cmimin.

KREU IV
LLOJET DHE PËRZGJEDHJA E PROCEDURËS TË PROKURIMIT
TE MALLRAVE DHE SHËRBIMEVE USHTARAKE

Autoriteti Kontraktor për prokurimin e mallrave, produkteve dhe shërbimeve, që nuk i nënshtrohen ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" (neni 5), vepron në zbatim të kesaj rregullore. Procedurat e prokurimit të jenë; "Procedure e Kufizuar", "Procedura me Negocim të Drejtëpërdrejtë" dhe Procedure e prokurimit "Shtet me Shtet".

1. Procedura e kufizuar

Procedura e kufizuar përdoret për llojet e armëve, të municioneve, sistemeve, e materialeve luftarake dhe të shërbimeve, të lidhura me to. Ajo është procedura, përmes së cilës marrin pjesë vetëm operatorët ekonomikë të përzgjedhur nga autoriteti kontraktor. Në këtë procedure merret në konsideratë që:

- a) Përzgjedhja e operatoreve ekonomike bëhet në baze të natyrës së kontratës, vendimit të BMP dhe studimit të realizuar nga Drejtoria e Menaxhimit të Projekteve të Modernizimit.
- b) Njoftimi i kontratës u dërgohet vetëm subjekteve që janë studiuar si kandidatë të mundshëm. Ky njoftim përmban informacionin e nevojshëm sipas përcaktimit të bërë për këtë hap të procesit.
- c) Ftesa për ofertë u dërgohet vetëm kandidatëve të përzgjedhur. Ajo përmban të gjithë informacionin e nevojshëm, në mënyrë që t'i lejojë kandidatët e përzgjedhur të dorëzojnë ofertat e tyre.
- d) Në përcaktimin e afatit kohor për procedurën e kufizuar dhe me negocim të drejtëpërdrejtë mbahet në konsideratë kompleksiteti i

kontratës dhe koha e kërkuar për hartimin e ofertave.

Pas dorëzimit të ofertës nga operatorët ekonomikë, të cilët janë përzgjedhur, për pjesëmarrje, në procedurën e kufizuar; autoriteti kontraktor bën vlerësimin e ofertave, duke përcaktuar ofertën më të leverdishme në këndvështrimin financiar dhe operacional e teknik. Në rast se një ose disa oferta konsiderohen të pavlefshme/skualifikuara dhe mbetet vetëm një ofertë e vlefshme, autoriteti kontraktor e analizon atë dhe në rast se e konsideron ofertë të arsyeshme e shpall fitues dhe urdhëron fillimin e procesit të negociimit. Në rast se asnjë nga subjektet pjesëmarrëse në tender nuk plotësojnë kërkesat dhe ofertat konsiderohen të pavlefshme, procedura anulohet dhe rihapet.

2. Procedura me negociim të drejtpërdrejtë

Procedura me negociim të drejtpërdrejtë është procedura, përmes së cilës autoriteti kontraktor ka arsye të përzgjedhe vetë operatorin ekonomikë dhe negociacion kushtet e kontratës. Ai, mund të realizojë procedurat e prokurimit me negociim të drejtpërdrejtë për të gjitha llojet e kontratave në rastet kur sigurohet vetëm një ofertë dhe ka argumenta të mjaftueshme për prokurimin e drejtpërdrejtë. Kjo procedurë realizohet kur bazohet në njërin ose disa nga argumentat e mëposhtme:

- a) kur për arsye që lidhen me të drejtat ekskluzive ose të drejtat e autorit, kontrata nuk mund të ekzekutohet përveçse nga një operator i vetëm ekonomik;
- b) kur është paraqitur vetëm një ofertë e përshtatshme, pas dërgimit të kërkesës për pjesëmarrje në tenderin me procedurë të kufizuar, ose një kërkesë për çmim dhe disponueshmeri, të subjektet që janë konsideruar të mundshme.
- c) kur ka një nevojë urgjente, për shkaqe jashtë kontrollit apo parashikimit të autoritetit kontraktor, që kanë të bëjnë me fatkeqësi natyrore ose rast krize dhe kur afati kohor limit për procedura të konkurimit, nuk mund të realizohet. Rrethanat e krijuara, në asnjë rast nuk duhet të përdoren për investimet komplekse, të cilat zgjasin më shumë se një vit buxhetor.
- d) në rast se mallrat e kërkuara janë vijim i investimeve të mëparshme të shtetit, pajisjes, armatimit e teknikës ekzistuese, të realizuara nëpërmjet fondeve publike (buxhetore, fonde ndihmë) ose ndihmave logjistike. Në këtë rast afati i përdorimit të sistemit ekzistues nuk duhet të ketë kaluar 50% të jetëgjatësisë së tij, të përcaktuar në aktet administrative të Këshillit të Ministrave. Për këtë në çdo rast duhet të ketë një argumentim të përgatitur nga struktura e ngarkuar për këtë qëllim dhe të miratuar nga BMP-se. BMP studion dhe vlerëson nëse një investim i tillë është i argumentuar dhe me interes për Forcat e

Armatosura.

- e) ne rast se blerja e mallrave apo shërbimeve është e njejte me ato eksistuese te Forcave te Armatosura dhe ndryshimi i furnizimit me tipe te ndryshme do te rezultojte me mallra me karakteristika të ndryshme teknike, që çojnë ne vështirësi operationale, teknike, mirëmbajtje dhe trajnimi kompleks të personelit.
- f) ne rastin e zgjatjes së kontratave të prokurimit se mallrave ose shërbimeve, nëse nevoja për mallra/shërbime shtesë është shkaktuar nga rrethana të paparashikuara, që nuk varen nga autoriteti kontraktor, dhe që nuk mund të ndahen, teknikisht ose ekonomikisht, nga kontrata fillestare, pa sjellë ndikime negative ose kosto të mëtejshme për autoritetin kontraktor, por që janë të nevojshme për përfundimin e kontratës fillestare.
- g) në rastin kur autoriteti kontraktor gjykon se një procedurë tjetër rezikon të japë të dhëna që mund të çënojnë interesa thelbësore të mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare.

3. Prokurimet Shtet me Shtet

Prokurimet Shtet me Shtet mund te realizohet në dy forma: Prokurim i Drejtperdrejtë dhe Autorizimi i nje shteti tjetër per te kryer procedura prokurimi ne emer te autoritetit kontraktor.

a). Prokurimi i Drejtperdrejte Shtet me Shtet është procedura, permes se ciles Autoriteti Kontraktor realizon prokurime tek nje Ministri Homologe ose struktura vartese te saj me kushtet, çmimet e standartet, që ato zbatojnë për forcat e tyre të armatosura.

b). Autorizim i nje shteti per te kryer procedura prokurimi ne emer te autoritetit kontraktor, është procedura, permes se ciles autoriteti kontraktor autorizon nje ministri homologe ose strukture vartese te tij per te realizuar procedure prokurimi, në interes të Forcave te Armatosura, me kushtet, çmimet e standartet, që ato zbatojnë për forcat e tyre të armatosura. Ne kete rast autoriteti kontraktor transferon paraprakisht fondin financiar te shteti perkates, pas autorizimit te marre nga Ministria e Financave.

Prokurimet shtet me shtet mund te behen me kontrata nje vjecare ose kontrata disa vjecare. Ne rastin e kontratave disa vjecare duhet te kete nje marreveshje shetëtrore. Kontrat një vjecare mund të kryhet edhe kur aplikohet një "kërkesë e vecantë".

Procedura e prokurimit shtet me shtet përfshin dërgimin e Kërkeses per Prokurim ose Kërkeses per Cmim dhe Disponueshmeri ne ato

vende te cilave u beson realizimin e procedurave te prokurimit, sipas sistemit te tyre te prokurimit. Ky tip prokurimi mund te realizohet ne keto raste:

- i) Kur testimi i mallit apo sherbimit te caktuar kerkon analize teknike komplekse dhe Forcat e Armatosura nuk kane mundesi ta kryejne ate.
- ii) Kur një formë tjetër prokurimi, e përcaktuar në këtë rregullore ka dështuar ose ka argumenta të qëndrueshme që dëshmojnë për mungesë leverdishmërie për shkak të cmimit ose të cilësisë së dobët së mallit.
- iii) Kur ekzistojne kontrata te mëparshme te kesaj kategorie (prokurime shtet me shtet) dhe ajo vleresohet më e leverdishme se sa blerja e drejtpërdrejte te një subjekt ekonomik, që operon me këtë shtet, ose me shtete të tjerë.
- iv) Kur ka një nevojë urgjente, për shkaqe jashtë kontrollit apo parashikimit të autoritetit kontraktor, që kanë të bëjnë me fatkeqësi natyrore ose rast krize dhe kur afati kohor limit për procedura te konkurimit, nuk mund të realizohet sipas paragrafit "c" të pikës 2 të kreut IV të jësaj rregulloreje. Rrethanat e krijuara, në asnjë rast nuk duhet të përdoren për investimet komplekse, të cilat zgjasin më shumë se një vit buxhetor.

KREU V

ZHVILLIMI I PROCEDURAVE TË PROKURIMIT TE MALLRAVE, PRODUKTEVE DHE SHERBIMEVE USHTARAKE

1. Njësia e prokurimit dhe urdhri për prokurim

a) Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar prej tij është përgjegjës për organizimin dhe realizimin e procedurës së prokurimit. Ai duhet të sigurojë një ndarje të qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit. Kërkesat ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi, duhet të mbahen parasysh përpara emërimit të një nëpunësi prokurimi. Çdo nëpunës, që merr pjesë në procesin e prokurimit, nënshkruan një deklaratë përmes së cilës deklaron se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit. Nuk lejohet që titullari i autoritetit kontraktor apo nëpunësi autorizues të drejtojë një komision ose të marrë pjesë në fazën e procedurës së përzgjedhjes, përveç detyrave që ai ushtron, në përputhje me këto rregulla.

b) Autoriteti kontraktor ngre njësine e prokurimit per realizimin e procedurave te prokurimit per llojet e armëve, të municioneve, sistemeve

e materialeve luftarake dhe të shërbimeve, të lidhura me to. Ajo duhet të administroje, procesin e prokurimit. Njësia e prokurimit përbëhet të paktën nga 3 persona me arsim të lartë, ku njëri prej tyre duhet të jetë jurist. Anëtarët e njësisë së prokurimit duhet të kryejnë të paktën një trajnim në vit, për çështjet e prokurimit publik ose te prokurimit ushtarak.

Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar prej tij, i cili është përgjegjës për organizimin dhe realizimin e procedurës së prokurimit duhet të beje nje ndarje te qarte te pergjegjesive te strukturave te ndryshme qe kane rol ne procesin e modernizimit te Forcave te Armatosura dhe te realizimit te procedurave te prokurimit ushtarak. Per kete duhet te kete ndarje te qarte ndermjet sektorëve hartues te kerkesave operacionale dhe kerkesave kryesore teknike te llojet e armëve, municioneve, sistemeve, dhe materialeve luftarake, te shërbimeve, të lidhura me to, integritit te kerkesave operacionale ne programe te perbashketa, shqyrtimit, studimit, analizes dhe vendimarrjes per klasifikimin e tyre, si pjese e pergjegjesise se bordit të modernizimit, shnderrimit te kerkesave operacionale ne propozim teknik (projekt ose detyre projektimi), miratimit te alternatives nga BMP, ndjekjes se procedures se prokurimit, selektimit te ofertes, negocimit te kontrates, ndjekjes se realizimit te kontrates dhe dorezimit te perdoruesi.

Ne rastin kur hapa te ndryshme te ketij procesi behen nga të njëjtët elementë strukture, personat qe marrin pjese ne nje hap te procesit nuk duhet te perfshihen ne hapin tjetër.

c) Përveç detyrave të përcaktuara në këto rregulla ose të detyrave të tjera, që i ngarkohen nga autoriteti kontraktor, njësia e prokurimit është përgjegjëse për parashikimin e afatit të prokurimeve ushtarake, për hartimin e urdhrave të prokurimit, për mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme, që u bashkëlidhen dokumenteve të tenderit si kerkesat operacionale, Vendimin e BMP dhe miratimin e autoritetit kontraktor, standartet e NATO-s, dhe dokumenta te tjera ne pershtatshmeri me vecorine e procedures se prokurimit, duke përfshirë edhe procesverbalet e mbledhjeve.

ç) Kur sigurohen fondet dhe ka nevojë për mallra dhe shërbime, titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit, i cili duhet të përmbajë te paktën:

- i) objektin e prokurimit;
- ii) fondin e vënë në dispozicion;
- iii) llojin e procedurës së prokurimit dhe arsyet e përdorimit të saj.

Komisioni i vlerësimit të ofertës dhe Komisioni i negocimit të kontrates mund të përcaktohen në urdhër të vëçantë. Ata mund të jenë një komision i perbashket ose i vecante ne varesi nga natyra e prokurimit dhe kompleksiteti i objektit të prokurimit. Ne rastin e prokurimit të kufizuar keto komisione te jene te ndryshem. Anetaret e komisionit të vlerësimit të mos përfshihen në komisionin e negocimit. Keto komisione

mund te percaktohen ne urdher te vecante, por jo me vonë se 5 ditë përpara afatit të fundit të dorëzimit të ofertave/kërkesave dhe jo me pak se 15 dite nga dita e fillimit te negociimit te kontrates.

2. Hartimi i dokumenteve të tenderit

a) Njësia e prokurimit per mallrat dhe shërbimet është përgjegjëse për hartimin e dokumenteve të tenderit, kërkesat për kualifikim dhe kriteret e vlerësimit, ndërsa hartimi i specifikimeve operationale dhe teknike përgatiten nga sektore te tjere, të specializuara për objektin që prokurohet. Gjatë procesit të hartimit të dokumenteve duhet të mbahet procesverbal, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit.

Për vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, të parashikuar në këto rregulla, njësia duhet të argumentojë me hollësi vendosjen e tyre, sipas natyrës dhe vëllimit të kontratës.

Në rastet e kontratave komplekse ose të kontratave që kërkojnë njohuri të veçanta, teknike a juridike, autoriteti kontraktor mund të punësojë specialistë të jashtëm ose kontraktorë, për të ndihmuar njësinë në hartimin e dokumenteve të tenderit. Në hartimin e këtyre dokumenteve, autoriteti kontraktor duhet të përdorë dokumentet standarde të tenderit. Dokumentet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, që i kanë hartuar ato.

b) Pas hartimit të dokumenteve të tenderit, titullari i autoritetit kontraktor apo nëpunësi i autorizuar, ne pershtatshmeri me tipin e procedures se prokurimit, miraton njoftimin e kontratës. Në këtë njoftim shënohen ora, data dhe adresa e dorëzimit dhe hapjes së ofertave. Dokumentat e tenderit mund te dorëzohen nga operatorët ekonomike, pas njoftimit te marre. Ato mund te postohen si dokument hard copy ose te dergohen ne menyre elektronike. Ne rastin e kontratave te sistemeve ose shërbimeve që përmbajnë informacion ekspozimi i të cilit është në kundërshtim me interesat e sigurisë kombëtare, me operatorin ekonomik nënshkruhen nje dokument per ruajtjen e informacionit. Dokumentacioni i dergohet vetem ministrive homologe, strukturave vartese te tyre ose subjekteve që operojne me vendet anerate te NATO-s, te cilat jane zgjedhe nga autoriteti kontraktor.

c) Njësia e prokurimit është përgjegjëse për lëshimin e një kopjeje të dokumenteve të tenderit për çdo operator ekonomik apo shtet te miratuar nga autoritetit kontraktor. Nëse një operator ekonomik kërkon ndonjë sqarim, titullari i njësisë së prokurimit ia komunikon këtë me shkrim. Shtyrja e afatit kohor, si rezultat i ndryshimit të dokumenteve të tenderit, hyn në fuqi vetëm pas propozimit të njësisë së prokurimit dhe autorizimit, me shkrim, të titullarit të autoritetit kontraktor, ose të nëpunësit të autorizuar prej tij.

c) Komisioni i vlerësimit të ofertave, përbëhet nga jo më pak se 3 persona, specialistë të fushës, dhe është përgjegjës vetëm për shqyrtimin e ofertave. Në çdo rast, numri i anëtarëve duhet të jetë tek. Personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit nuk mund të emërohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave. Kryetari i komisionit duhet të përzgjidhet ndërmjet zyrtarëve të lartë drejtues të autoritetit kontraktor dhe është përgjegjës për fillimin e punës menjëherë pas krijimit të komisionit. Komisioni duhet të zbatojë detyrat në pavarësi të plotë dhe, nëse kërkohen sqarime për dokumentet e tenderit, këto merren nga njësia e prokurimit. Komisioni nuk kryen asnjë veprim tjetër, përveç atyre të përcaktuara shprehimisht në këto rregulla.

3. Dorëzimi i ofertave

a) Ofertat duhet të dorëzohen në adresën e përcaktuar në dokumentet e tenderit brenda afatit kohor, të përcaktuar në këto dokumente si afati i fundit për dorëzimin e ofertave. Menjëherë pas skadimit të afatit përfundimtar, komisioni për vlerësimin e ofertave fton përfaqësuesit e operatorëve ekonomikë të paraqesin ofertat/provizimet e tyre, të mbyllura në zarf ose verifikon ato që janë dorëzuar më parë në njërin nga mënyrat e parashikuara në dokumentet e tenderit. Çdo ofertë e dorëzuar pas afatit të përcaktuar në njoftimin e autoritetit kontraktues nuk shqyrtohet nga komisioni dhe kthehet e pahapur kandidatit/ofertuesit. Subjeketeve ekonomike mund tu kërkohej që zarfi i mbyllur duhet të përmbajë 3 zarfe, atë me kualifikimet e kandidatit/ofertuesit, me ofertën teknike dhe me ofertën ekonomike. Ofertë mund të konsiderohet edhe Kërkesa për disponueshmëri e dhënë nga operator/operatorët ekonomik (sublekt ose shtet).

b) Në rastin e procedurës së prokurimit të drejtperdrejte me një subjekt ekonomik, ose shtet, zarfi mund të jetë një i vetëm.

c) Zarfet paraqiten sipas përcaktimit në dokumentet standarde të tenderit, origjinale dhe kopje. Mosparaqitja sipas përcaktimit apo mungesa e çdo elementi të bën ofertën të pavlefshme. Në këtë rast, oferta s'kualifikohet, por zarfi nuk i kthehet ofertuesit.

4. Hapja dhe vlerësimi i ofertave

a) Komisioni hap dhe lexon ofertat, në përputhje me përcaktimet në këto rregullore.

Anëtarët e njësive së prokurimit, që kanë marrë pjesë në hartimin e dokumenteve të tenderit, janë të pranishëm gjatë fazës së hapjes dhe të vlerësimit, por nuk kanë të drejtë të votojnë ose të ndikojnë në procesin e shqyrtimit. Ata mund të japin mendime vetëm kur u kërkohet, si dhe kryejnë funksione të karakterit ndihmës, si mbajtja e procesverbalit, sistemimi dhe ruajtja e dokumenteve.

b) Në procedurën e tenderit të kufizuar, ku kriteri është oferta më perparaesi me të madhe ekonomike, komisioni i vlerësimit lexon emrin dhe adresën e ofertuesit dhe hap zarfin përkatës. Më tej ky komision hap zarfin e dokumenteve të kualifikimit dhe lexon listën e dokumenteve të paraqitura nga ofertuesi. Në vazhdim hapen ofertat teknike dhe ofertat ekonomike. Komisioni u komunikon përfaqësuesve ditën, vendin dhe orën për klasifikimin përfundimtar të ofertuesve dhe më pas vazhdon punën për shqyrtimin e ofertave. Në fillim shqyrtohet dokumentacioni ligjor dhe kualifikues. Më pas komisioni vazhdon vlerësimin e ofertave teknike të kandidatëve të kualifikuar dhe bën klasifikimin teknik. Më pas kalohet në shqyrtimin e ofertës ekonomike. Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë vetëm me shkrim ose të pasqyruara në procesverbalin e prokurimit. Per kontratat komplekse autoriteti kontraktor ka të drejte të beje testimin e mallit/sistemit, por duke e njoftuar kete paraprakisht. Testimi behet ne menyre te njejte per te gjithë subjektet ekonomike, sipas planit te testimit te miratuar. Koha e testimit negociohet me subjektet ekonomike. Ajo nuk mund te fillojë para dorëzimit të ofertes dhe duhet të perfundoje para shpalljes se fituesit. Në bazë të ofertave të pranuar, komisioni i vlerësimit harton renditjen përfundimtare, e cila duhet të komunikohet në kohën e njoftuar, por, në çdo rast, jo më vonë se 30 ditë nga data e dorëzimit të ofertave. Ne rast te mos realizimit te kohes se vleresimit te ofertes, autoriteti kontraktor ka te drejte te shtyje kohen duke e pasqyruar kete ne forme shkresore.

c) Në bazë të ofertave të pranuar, komisioni i vlerësimit harton klasifikimin përfundimtar, i cili u komunikohet ofertuesve në kohën e përcaktuar.

d) Autoriteti kontraktor mund të verifikojë vetëm informacionin e dorëzuar nga ofertuesit, të renditur i pari dhe i dyti në klasifikim. Kryetari i komisionit të vlerësimit, pas përfundimit të vlerësimit të ofertes, përgatit një raport përmbledhës dhe i propozon fituesin titullar të autoritetit kontraktor.

e) Pas shqyrtimit të ankesave të dorëzuara, nëse ka të tilla, titullari i autoritetit kontraktor bën njoftimin e fituesit.

f) Autoriteti kontraktor pas shpalljes së fituesit, në pershtatshmeri me objektin e kontrates vepron si më poshte:

- i) Per projekte, te cilat konsiderohen me ndikim ne çeshtjet e sigurise kombëtare, kontrata dergohet per miratim ne Keshillin e Ministrave,
- ii) Per kontratat e tjera vijohet me negocimin e tyre.

g) Çdo hap i procedurës së prokurimit duhet të regjistrohet dhe të pasqyrohet në procesverbalin e prokurimit. Njëri nga anëtarët e njësisë

së prokurimit është gjithmonë përgjegjës për regjistrimin e çdo faze të procesit dhe teksti përfundimtar i tij duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit. Nëse anëtarët e komisionit kanë mendime të ndryshme, ose nëse komisioni vendos me votim, kjo gjë duhet të pasqyrohet në procesverbal. Dokumentet, që shoqërojnë ofertën nuk i kthehen ofertuesve, por mbeten pjesë e dosjes së procedurës, dhe administrohen prej tij.

5. Negocimi i kontratës

Pas miratimit të fituesit nga autoriteti kontraktor, autoriteti kontraktues urdhëron krijimin e grupit të negocimit të kontratës për kushtet e kontratës përfundimtare për prokurimin e mallrave, të produkteve dhe shërbimeve që nuk i nënshtrohen ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar (neni 5) dhe të përshkruar në këtë rregullore. Ky grup, në përbërje të tij të ketë jurist, ekonomist, specialist të fushës dhe përfaqësues nga DMPM. Në çdo rast, në grupin e negocimit, të përfshihet menaxheri i fushes përkatëse që do të zbatojë kontratën dhe përfaqësuesi i strukture ushtarake përfituese nga projekti. Draft-kontrata hartohet në gjuhën shqipe dhe angleze. Pas përfundimit të negocimit, Ministri i Mbrojtjes autorizon personin përgjegjës për nëshkrimin e saj.

Negocimi i kontratës bëhet në rastin e aplikimit të procedurës së prokurimit të kufizuar dhe të negocimit të drejtpërdrejtë.

KREU VI

ZHVILLIMI I PROCEDURËS PËR SHËRBIMET E KONSULENCËS DHE TE KONKURSIT TE PROJEKTIMIT.

1. Shërbimet e konsulencës

a) Shërbimet e konsulencës zhvillohen në përputhje me procedurat e përcaktuara në kreun IV të kësaj rregulloreje. Në shërbimet e konsulencës krahas subjekteve të përcaktuara në Kreun I dhe të III, mund të marrin pjesë dhe subjekte të tjera sipas shërbimit të konsulencës që ato të ofrojnë.

b) Dispozitat e mëposhtme janë njësoj të zbatueshme për konsulentin, si person, fizik ose juridik, për stafin e konsulentit dhe nënkonsulentët, si dhe për bashkimet e konsulentëve. Konsulentët mund të bashkohen me njëri-tjetrin, në formën e një bashkimi konsulentësh, ose me një marrëveshje nënkonsulente, për plotësimin e fushave të tyre përkatëse të ekspertizës, për fuqizimin e anës teknike të propozimeve të tyre dhe për vënien në dispozicion të një ekipi më të madh ekspertësh, për të realizuar mënyra më të mira, dhe, në disa raste, për të ofruar çmime më

të ulëta. Një bashkim i tillë mund të krijohet për një afat të gjatë, pavarësisht nga detyra specifike e çastit, ose mund të krijohet edhe për një detyrë të veçantë. Në çdo rast, ky bashkim duhet të dokumentohet me një kontratë të lidhur.

c) Në përlogaritjen e vlerës limit të shërbimit të konsulencës, autoriteti kontraktor duhet të ketë parasysh kompleksitetin e kontratës, përvojën e vendeve anëtare të NATO-s, kontrata të ngjashme të realizuara nga autoriteti kontraktor, ente të tjera prokurues në shkallë vendi, cmimet e kontratave të mëparshme, ose aktuale, të realizuara nga ministritë homologe dhe strukturat e tyre të varësisë të vendeve anëtare të NATO-s, për sisteme të tilla apo të ngjashme, deklaratimet në uebsite të NATO-s, të vendeve anëtare të NATO-s, ose të subjekteve që operojnë me këto vende. dhe mbi bazën e kostos dhe disponueshmërisë së ofruar nga ministri homologe të vendeve të NATO-s, struktura vartëse të tyre ose operatorë ekonomik që operojnë me to.

d) Autoriteti kontraktor, përveç kriterëve të përcaktuara në kete rregullore, për përjashtimin e kandidatëve ose të ofertuesve, duhet të të ketë parasysh edhe:

- i) konfliktin ndërmjet veprimtarive të konsulencës dhe prokurimit të mallrave, punëve ose shërbimeve, kur një operator është angazhuar nga autoriteti kontraktor për të furnizuar mallrat e për punët ose shërbimet (me përjashtim të shërbimeve të konsulencës) për një projekt, dhe secili prej anëtarëve të tij, duhet të s'kualifikohet nga ofrimi i shërbimeve të konsulencës, që lidhen me këto mallra, punë e shërbime. Nga ana tjetër, një operator, i punësuar për të dhënë shërbime konsulence, për përgatitjen ose zbatimin e një projekti, dhe secili prej anëtarëve të tij, duhet të s'kualifikohet nga furnizimi i mallrave e nga punët ose shërbimet (me përjashtim të shërbimeve të konsulencës), që rrjedhin ose janë të lidhura drejtpërdrejt me shërbimet e konsulencës së shoqërisë për këtë përgatitje ose zbatim.
- ii) konfliktin ndërmjet detyrave të konsulencës. As konsulentët dhe as ndonjëri prej anëtarëve në subjektet e tyre nuk duhet të punësohen për kryerjen e ndonjë detyre, që, për nga natyra e saj, mund të jetë në konflikt me një detyrë tjetër të konsulentëve.
- iii) marrëdhënien me stafin e autoritetit kontraktor: konsulentët (përfshirë personeli i tyre dhe nën-konsulentët) që kanë marrëdhënie, biznesi ose familjare, me një anëtar të stafit të autoritetit kontraktor, drejtpërdrejt ose jo, i përfshirë në ndonjë pjesë të përgatitjes së kushteve të kontratës, dhe/ose në procesin e përzgjedhjes për këtë kontratë, dhe/ose për mbikëqyrjen e kësaj kontrate.

e) Në procedurën e përzgjedhjes së fituesit përfshihen:

- i) Urdhri. Titullari i autoritetit kontraktor apo personi i autorizuar nxjerr urdhrin e prokurimit, me të njëjtën përmbajtje, siç përcaktohet në germenin ç", të pikës 1, të kreut V, të kesaj rregullore.
- ii) Përgatitja e projektkontratës. Njësia e prokurimit apo edhe struktura të specializuara, të caktuara nga titullari, duhet të hartojnë projektkontratën dhe dokumentet e tenderit, me përkufizime të qarta të objektivave, qëllimeve dhe të synimit të detyrës në fjalë, ku të përfshihen një informacion kryesor për kandidatët e interesuar dhe rezultatet e pritura nga shërbimi që do të jepet.
- iii) Përgatitja e preventivit të cmimit dhe buxheti. Preventivi i cmimit bazohet në vlerësimin që autoriteti kontraktor u bën burimeve, që i nevojiten për të përmbushur detyrën: cmimi-kostoja për stafin, mbështetja logjistike dhe inputi fizik.
- iv) Njoftimi. Për të marrë deklaratat e shprehjes së interesit, autoriteti kontraktor bën njoftimin e kërkesës sipas procedurave të përcaktuara në këtë rregullore.
- v) Lista e shkurtër e kandidatëve. Autoriteti kontraktor, në rastin e zhvillimit të procedurës së kufizuar, shqyrton kualifikimet e kandidatëve, që shprehin interes, në bazë të kriterëve të përzgjedhjes, të përcaktuara në njoftim. Kandidatët, që nuk i plotësojnë kriteret e kualifikimit, s'kualifikohen dhe njoftohen menjëherë për këtë ç'kualifikim. Lista e shkurtër përfshin të paktën 3 kandidatë. Në rastet kur numri i kandidatëve, që kanë shprehur interes, është më i ulët se minimumi i përcaktuar, autoriteti kontraktor mund të vazhdojë me procedurën, me kusht që të mbeten të paktën 2 kandidatë.

f) Autoriteti kontraktor i bën kërkesë për propozime, me shkrim, kandidatëve të përcaktuar në listën e shkurtër, në të cilën përfshihen:

- i) ftesa, ku deklarohen qëllimi i autoritetit kontraktor për të nënshkruar kontratën për shërbimet e konsulencës, burimi i fondeve, hollësi të tjera për klientin, adresa, data, ora për dorëzimin e propozimeve;
- ii) udhëzimet për ofertuesit, ku jepet i gjithë informacioni i nevojshëm, që do t'i ndihmonte ofertuesit për përgatitjen e propozimeve, si dhe informacione për procesin e vlerësimit, kriteret e vlerësimit e faktorët e rëndësishëm përkatës të tyre, dhe për pikët minimale për cilësinë;
- iii) periudha e vlefshmërisë së propozimit;
- iv) kushtet e projektkontratës, që do të prokurorhet;
- v) afatet kohore për dorëzimin e propozimeve.

Marrja e propozimeve. Autoriteti kontraktor përcakton një afat kohor për dorëzimin e propozimeve, që u jep ofertuesve kohë të mjaftueshme për të përgatitur propozimet e tyre. Koha e lejuar është në varësi të objektit të kontratës dhe nuk duhet të jetë më pak se 20 ditë. Gjatë kësaj kohe, ofertuesit mund të kërkojnë sqarime për informacionet e dhëna në kërkesën për propozime. Autoriteti kontraktor i jep këto sqarime me shkrim dhe ua dërgon të gjithë kandidatëve të përcaktuar në listën e shkurtër. Nëse është e nevojshme, zgjat edhe afatet kohore për dorëzim. Propozimet, teknike dhe ekonomike, duhet të dorëzohen në të njëjtën kohë, në zarf a të veçanta, të mbyllura. Pas mbarimit të afateve kohore për dorëzim, nuk duhet të pranohet asnjë ndryshim i propozimeve, teknike ose ekonomike. Zarfet, që përmbajnë propozimet teknike, hapen menjëherë pas mbarimit të afatit për dorëzimin e propozimeve, ndërkohë që propozimet ekonomike mbeten të pahapura. Çdo zarf, që merret pas mbarimit të afatit, kthehet i pahapur.

g) Vlerësimi i propozimeve teknike dhe shqyrtimi i cilësisë. Vlerësimi i propozimeve teknike kryhet menjëherë, duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme:

- i. Përvojën e konsulentit;
- ii. Cilësinë e metodologjisë së propozuar;
- iii. Kualifikimet e stafit kryesor të propozuar;
- iv. Pervoja e tyre në aplikime në vende anetare të NATO-s, në pershtatshmeri me objektin e kontratës
- v. Transferimin e njohurive, nëse kërkohet.
- vi. Kriteret e tjera të cilat përcaktohen nga autoriteti kontraktor në pershtatshmeri me objektin e prokurimit.

Bazuar në kriteret e mesiperme autoriteti kontraktor ben vlerësimin perkates. Pësha e cdo kriteret përcaktohet në pershtatshmeri me objektin e kontratës. Vlerësimi i shërbimeve të konsulencës bazohet në kriterin e ofertës me përparësi më të madhe ekonomike.

Çdo kriter vlerësohet në një shkallë nga 1 deri në 100, e më tej pësha e tyre kthehet në pikë përkatëse. Pësha e propozuar përfshihet në kërkesën për propozime. Autoriteti kontraktor vë në dijeni ofertuesit, që kanë dorëzuar propozime, për cdo vlerësim teknik, me pikë për secilin konsulent, dhe njofton ata konsulentë, propozimet e të cilëve nuk kanë arritur të fitojnë pikët minimale, ose që janë vlerësuar se nuk i plotësojnë kërkesat për propozim. Autoriteti kontraktor i njofton menjëherë konsulentët, që kanë realizuar pikët minimale kualifikuese për datën, orën dhe adresën për hapjen e propozimeve ekonomike.

Hapja publike e propozimeve ekonomike. Propozimet ekonomike hapen publikisht, në prani të përfaqësuesve të konsulentëve, që marrin pjesë, vetë ose përmes telekonferencës apo mjeteve të tjera elektronike, nëse është e mundur. Emri i ofertuesit, pikët e vlerësimit teknik dhe

çmimet e propozuara lexohen me zë të lartë dhe regjistrohen gjatë hapjes së propozimeve ekonomike. Për vlerësimin, në çmim përfshihen të gjitha pagesat e konsulentëve, si dhe shpenzimet e tjera, si psh, shpenzimet për udhëtime, përkthimin, printimin e raporteve ose shpenzimet sekretariale. Propozimit me çmimin më të ulët mund t'i jepet vlerësimi financiar prej 100 pikësh, ndërsa propozimeve të tjera u jepen vlerësime ekonomike, që janë në përpjesëtim me çmimet e tyre. Metodologjia, që do të përdoret, duhet të përshkruhet në kërkesën për propozime.

S'kualifikimi i ofertuesve. Ofertuesit, që nuk plotësojnë kërkesat teknike dhe/ose ekonomike, s'kualifikohen. Autoriteti kontraktor duhet ta vëre në dijeni menjëherë ofertuesin e skualifikuar.

Vlerësimi përfundimtar i cilësisë dhe i cmimit. Vlerësimi total në pikë realizohet duke mbledhur pikët për cilësinë dhe cmimin. Pikët për "çmimin" caktohen, duke marrë parasysh kompleksitetin e objektit të kontratës së prokurimit, si dhe rëndësinë përkatëse të cilësisë.

h) Pas identifikimit të ofertës më të mirë, autoriteti kontraktor vë në dijeni ofertuesit për klasifikimin përfundimtar. Autoriteti kontraktor fillon bisedimet për të sqaruar dhe për të përmirësuar kushtet e kontratës, metodologjinë, përbërjen e stafit dhe kushtet e veçanta. Bisedimet nuk duhet t'i ndryshojnë në mënyrë thelbësore kushtet fillestare të kontratës ose propozimin e përzgjedhur. Oferta ekonomike nuk duhet të ndryshohet në asnjë rast.

i) Kur ofertuesi i suksesshëm nuk arrin të nënshkruajë kontratën me shkrim ose nuk arrin të bëjë sigurimin, për zbatimin e kontratës, nëse kërkohet, autoriteti kontraktor fton për negociim ofertuesin vijues në klasifikimin e ofertuesve.

j) Në rast se kontrata lidhet me një bashkim operatorësh, atëherë ky i fundit duhet të caktojë një nga shoqëritë pjesëmarrëse në këtë bashkim për ta përfaqësuar. Të gjithë anëtarët e bashkimit të operatorëve duhet të nënshkruajnë kontratën dhe të jenë, individualisht dhe bashkërisht, përgjegjës për detyrën.

2. Konkursi i projektimit

a) Konkursi i projektimit, zhvillohen në përputhje me procedurat e percaktuara në kreun IV të kësaj rregulloreje. Vlerësimi i konkursit të projektimit bazohet në kriterin e ofertës me përparësi më të madhe ekonomike. Ai zhvillohen në përputhje me procedurat e percaktuara në kreun IV të kësaj rregulloreje, ku në sigurimin projektit, krahas subjekteve të percaktuara në Kreun I dhe të III, mund të marrin pjesë dhe subjekte të tjera sipas shërbimit të konsulencës dhe certifikimit që zotërojnë.

b) Autoriteti kontraktor mund të organizojë konkursin e projektimit si pjesë të një procedure, që çon në përzgjedhjen e kontratës fituese për sigurimin e nje projekti per mallra dhe sherbime te kategorizuara per qellime te mirfillta ushtarake, që shpërblehet me anë të një çmimi ose pagese.

c) Konkursi i projektimit mund të organizohet për kontratat e mallrave dhe sherbimeve shume vjecare dhe në ato raste kur kjo konsiderohet dhe argumentohet si domosdoshmeri.

d) Nëse tenderi përfshin projektin dhe realizimin e shërbimeve, atëherë në dhënien e ofertës duhet t'i kushtohet vëmendje aspekteve teknike e ekonomike të projektit dhe mënyrave të realizimit të tij.

e) Në dokumentet e tenderit duhet të jepen saktë përkufizimet e specifikimeve teknike, për elementet strukturore dhe elementet e realizimit të projektit.

f) Përveç kriterëve përjashtuese, të parashikuara në nenin 45, të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", autoriteti kontraktor duhet të përjashtojë ata kandidatë, që janë punonjës të tij, ose që janë të përfshirë në më shumë se një projekt.

g) Autoriteti kontraktor mund të organizojë një konkurs projektimi, ku objekti është një projektide. Në këtë rast, në dokumentet e tenderit duhet të përcaktohen qartë kriteret e vlerësimit teknik dhe çmimi, që jepen për kandidatin fitues dhe për kandidatët e tjerë të pranuar.

h) Komisioni duhet të përbëhet nga një numër tek anëtarësh, pjesëtarë ose jo të autoritetit kontraktor, dhe ku shumica duhet të kenë të njëjtën licencë ose specializim, të përcaktuar në kërkesat për kualifikim të kandidatëve, në dokumentet e tenderit, si dhe një përvojë 10-vjeçare në çështjet e projektit, që do të prokurohet.

KREU VII

EKZEKUTIMI I KONTRATËS

1. Nënkontraktimi

a) Autoriteti kontraktor mund të lejojë nënkontraktimin, për realizimin e një pjese të kontratës. Në asnjë rast, kontraktorët nuk mund t'ia transferojnë kontratën palëve të treta.

b) Në dokumentet e tenderit duhet të përcaktohet qartë nëse lejohet ose jo nënkontraktimi. Në rastet kur mund të ketë nënkontraktor, autoriteti

kontraktor te shprehet qarte qe nuk do te beje pagesa te drejtpergrejta te nenkontraktoret.

c) Me dorëzimin e ofertave, ofertuesit duhet të deklarojnë punët, shërbimet ose mallrat, ose një pjesë të tyre, që ata kanë qëllim të nënkontraktjnë, në rast se shpallen fitues, si dhe nënkontraktorin e përzgjedhur. Per kontratat qe lidhen me ceshtje te informacionit, ekspozimi i të cilit është në kundërshtim me interesat e sigurisë kombëtare autoriteti kontraktor duhet qe te jete shprehur me pare per kushtezimet qe ekzistojne per nenkontraktoret.

ç) Përpara lidhjes së kontratës, ofertuesi i shpallur fitues duhet t'i dorëzojë autoritetit kontraktor një kopje të noterizuar të marrëveshjes së nënkontraktimit dhe dëshminë e kualifikimeve dhe të kërkesave teknike të nënkontraktorit, në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktor të mund të kaloje ne procedure miratimi nënkontraktimin.

d) Gjatë ekzekutimit të kontratës autoriteti kontraktor kontrollon nepermjet Menaxherit te Projektit, pjesë e strukturës së tij.

2. Mbikëqyrja e kontratës

a) Gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti kontraktor dhe/ose organe të tjera shtetërore, të autorizuara me ligj, mund të mbikëqyrin veprimtarinë e kontraktorit dhe vendin e zbatimit, sipas legjislacionit në fuqi apo sipas kërkesave, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

b) Autoriteti kontraktor, për t'u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë, monitoron zbatimin e kontrates nepermjet Sektorëve të Menaxhimit të Kontratave. Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve, vlereson realizimin e detyrime kontraktuale sipas fazave te realizimit te kontrates. Në përfundim të kontratës, autoriteti kontraktor përgatit një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës. Një kopje e këtij raporti i jepet edhe kontraktorit, me kërkesë të tij.

KREU VIII

SHQYRTIMI I ANKESAVE

a). Çdo person, që ka ose ka patur interes në një procedurë prokurimi, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, mund ta kundërshtojë këtë vendim.

b) Gjatë procedurës së prokurimit, ankesat duhet të dorëzohen pranë autoritetit kontraktor. Kundërshtimet mund t'i adresohen titullarit të autoritetit kontraktor brenda 5 ditëve nga data kur ankimesi është vënë

në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për këtë shkelje të ligjit.

c) Ankimuesi përdor formularin standard të ankesës, që përmban emrin dhe adresën e ankimuesit, referencën e procedurës konkrete, bazën ligjore, si dhe një përshkrim të shkeljes së pretenduar.

ç) Me marrjen e ankesës me shkrim nga ankimuesi, titullari i autoritetit kontraktor urdhëron njësinë e prokurimit dhe komisionin e vlerësimit të pezullojnë vazhdimin e procedurës, derisa ankesa të shqyrtohet plotësisht. Titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen një zyrtari apo zyre brenda autoritetit, për të shqyrtuar ankesën dhe për të dhënë një rekomandim për titullarin. Personi apo zyra e ngarkuar nuk duhet të ketë marrë pjesë në vendimmarrje, për të cilin është paraqitur ankesa. Njësia e prokurimit mbledh të gjithë informacionin e nevojshëm, për të shqyrtuar ankesën dhe për të ndihmuar zyrtarin e ngarkuar për shqyrtimin e saj. Në rast se ankimi lidhet me dokumentet e tenderit, titullari mund t'ia ngarkojë shqyrtimin e ankesës komisionit të vlerësimit të ofertës, nëse komisioni është ngritur.

d) Vendimi për ankesën duhet të merret brenda 10 ditëve nga marrja e saj. Nëse kërkohet informacion tjetër nga ankimuesi, atëherë afati kohor i sipërpërmendur ndërpritet dhe fillon përsëri pasi autoriteti kontraktor ta sigurojë këtë informacion. Autoriteti kontraktor duhet të informojë ankimuesin për vendimin dhe arsyet për këtë vendim të marrë, jo më vonë se 24 orë pas marrjes së vendimit.

dh) Autoriteti kontraktor, nëse nevojitet, duhet të zgjasë afatin kohor të procedurës së prokurimit aq sa zgjat periudha e pezullimit. Në rastet kur afatet kohore të procedurës së prokurimit, për të cilat janë njoftuar ofertuesit, ndryshojnë për shkak të marrjes parasysh të ankesës, autoriteti kontraktor u shpërndan ofertuesve një njoftim të posaçëm, ku jepen arsyet për zgjatjen e këtyre afateve.

RELACION

MBI



PROJEKTVENDIMIN

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PROCEDURAT QË PËRDOREN NGA MINISTRIA E MBROJTJES PËR PROKURIMIN E DISA MALLRAVE DHE SHERBIMEVE TE PERJASHTUARA NGA RREGULLAT E PËRGJITHSHME TE PROKURIMIT PUBLIK.

Në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga Strategjia Kombëtare për Integrim dhe Zhvillim, Strategjia Ushtarake dhe Plani Afatgjatë i Zhvillimit të FA-së, Forcat e Armatosura kanë hyrë në rrugën e një reforme që konsiston në një transformim të thellë të konceptit strategjik, të doktrinës, të personelit, të strukturës organizative, të infrastrukturës ushtarake dhe të modernizimit të pajisjeve, sistemeve dhe teknikës, në bazë të standarteve të NATO-s.

Marrja e ftesës së antarësimit në NATO në Samitin e Bukureshtit, rritja e pjesëmarrjes së Forcave të Armatosura në Operacionet në Mbështetje të Paqes, Realizimi i Objektivave të Partneritetit (PG) e shndërrimi i tyre në Objektiva Force, kërkesat për rritjen e operacionalitetit të strukturave të deklaruara në NATO/PfP, dhe objektivat që rrjedhin nga dokumentet themelore të integritimit, janë disa nga faktorët që bëjnë të domosdoshëm modernizimin e Forcave të Armatosura.

Me qëllim menaxhimin e procesit të modernizimit, Ministria e Mbrojtjes, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 521, datë 08.08.2007 "Për procedurat e blerjes nga Ministria e Mbrojtjes të disa mallrave, të përjashtuara nga rregullat e përgjithshme të prokurimit publik" dhe në zbatim të Urdhërit të Kryeministrit Nr. 50, datë 2.05.2008 "Për disa ndryshime në Urdhërin Nr. 20, datë 07.02.2005 "Për miratimin e strukturës së Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura", ka krijuar strukturën përkatëse për realizimin e procesit të prokurimit të armatimit, municionit, sistemeve dhe materiale luftarake që lidhen me to.

Realizimi i procesit të modernizimit të FA dhe në mënyrë të veçantë realizimi i procedurave të prokurimit për mallrat dhe shërbimet që nuk i nënshtrohen ligjit të prokurimeve publike, kërkon përcaktimin e rregullave dhe procedurave përkatëse. Rregullorja e prokurimeve të mallrave dhe produkteve ushtarake është hartuar në përshtatshmëri me

Vendimin Nr. 1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", duke bërë ndryshimet e nevojshme në përshtatshmëri me objektin e prokurimit.

Miratimi i Rregullave dhe procedurave të prokurimit ushtarak konsiderohet domosdoshmëri, sepse:

- Mësimet e nxjerra nga vitet e mëparshme, kanë evidentuar domosdoshmërinë e përmirësimit dhe zhvillimit të mëtejshëm të procesit të modernizimit të FA, krijimit të ekspertizës së nevojshme për unifikimin e standardeve dhe procedurave, me synim krijimin e kapaciteteve operationale, sipas standardeve të NATO-s. Përvoja e deritanishme e një pune të decentralizuar në njësi dhe Komandat Kryesore, ka treguar mangësi e pamundësi për një proces të plotë.
- Rritja e pjesës së buxhetit për mbrojtjen me 2% të GDP, dhe miratimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 521, datë 8.8.2007 "Për procedurat e blerjes nga Ministria e Mbrojtjes të disa mallrave të përjashtuara nga rregullat e pergjithëshme të prokurimit publik", ka krijuar një situatë të re e cila kërkon të mbështetet me procedura. Kjo, jo vetëm që do të japë efektet në realizimin ritmik të investimeve, por do të rritë më shumë transparencën në prokurimet ushtarake dhe do ta orientojë procesin e modernizimit në një rrugë të balancuar të vendimmarrjes në Nivelin Strategjik të Komandimit e Drejtimit të Forcave të Armatosura. Për këtë projektvendimi parashikon shfuqizimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr 521, datë 8.8.2007 dhe propozon një Vendim të ri, pjesë e të cilit është Rregullorja e procedurave të prokurimit që, do të përdoret nga Ministria e Mbrojtjes në zbatim të gërmave "a" dhe "b" të pikës 2 të nenit 5 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik".
- Aktualisht Forcat e Armatosura kanë në proces implementimi dy kontrata të rëndësishme, si kontrata për ndërtimin e Sistemit të Integruar të Vëzhgimit të Hapësirës Detare (SIVHD), me kontraktor Korporatën Lockheed Martin dhe kantatën për Ndërtimin e Anijeve, me kontraktor Damen Shipyard. Përvoja e këtyre kontratave ka evidentuar nevojën e një pune në grup me specialistë me përvojë në fushën e menaxhimit të kontratave. Gjithashtu, krijimi i Drejtorise së Menaxhimit të Projekteve të Modernizimit dhe mbështetja me bazën e nevojshme ligjore do të japë ndikimet pozitive në këtë proces.

Mbështetur në përvojën e vendeve anëtare të NATO-s, rezulton se për projekte të rëndësishme, të cilat konsiderohen se kanë ndikim të veçantë në çështjet e mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare, është e domosdoshme që kontratat të miratohen në nivelet më të larta të zinxhirit të komandimit e të drejtimit strategjik. Në projektvendimin e Këshillit të Ministrave në pikën 3 është parashikuar një përcaktim i tillë.

Rregullorja e procedurave të prokurimit që do të përdoren nga Ministria e Mbrojtjes, në zbatim të gërmave "a" dhe "b" të pikës 2 të nenit 5 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "për prokurimin publik", ka një strukturë të ngjashme me atë të Rregullores së procedurave të prokurimit publik, që përdoren në zbatim të Ligjit të mësipërm. Ajo është e ndërtuar me tetë kapituj në të cilët përshkruhen, përkufizimet e termave, organizimi i prokurimit të mallrave e shërbimeve, rregullat e përgjithëshme, llojet dhe përzgjedhja e procedurës së prokurimit, zhvillimi i procedurës së prokurimit, shërbimet e konsulencës, ekzekutimi i kontratës dhe shqyrtimi i ankesave.

Disa nga rregullat dhe procedurat e parashikuara në këtë rregullore janë:

- Autoriteti kontraktor është përgjegjës për prokurimet me fonde publike, të vëna në dispozicion të tij, në përputhje me përcaktimet e këtij projektvendimi të Këshillit të Ministrave.
- Kontrat që lidhen me prokurimin e pajisjeve, armatimit e municioneve, teknikës e sistemeve që do të blihen sipas këtij vendimi, klasifikohen në kontrata një vjecare dhe shumë vjecare.
- Gjate prokurimit të mallrave, produkteve dhe shërbimeve, që nuk i nënshtrohen gërmave "a" dhe "b" të nenit 5 të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", përdoren dokumentat standarte të tenderit duke bërë modifikimet e nevojshme, në përshtatshmëri me këtë projektvendim.
- Llojet e procedurave të prokurimit, sipas përcaktimit të këtij projektvendimi, do të kategorizohen në "Procedurë e Kufizuar", "Procedurë me Negocim të Drejtëpërdrejtë" dhe procedurë e prokurimit "Shtet me Shtet". Në këtë rregullore janë përshkruar me detaje rastet kur mund të përdoret secila nga llojet e mësipërme të prokurimit.

- Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar prej tij është përgjegjës për organizimin dhe realizimin e procedurës së prokurimit. Ai duhet të sigurojë një ndarje të qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit.

Hartimi i kësaj rregulloreje është bërë edhe me asistencën e kompanisë amerikane Kubik që asiston Ministrinë e Mbrojtjes në kuadrin e bashkëpunimit me SHBA, si dhe duke marrë modelet e përshtatëshme të vendeve antare të NATO-s.

Miratimi i Rregullores për procedurat e prokurimit nga Ministria e Mbrojtjes të disa mallrave, të përjashtuara nga rregullat e përgjithshme të prokurimit publik, do të vendosë procesin në baza ligjore, do të rritë transparencën e në procesin e modernizimit dhe të prokurimit të mallrave dhe shërbimeve që përjashtohen nga Ligji i prokurimeve publike.

Përgatitja e këtij drafti përvec domosdoshmërisë është edhe detyrë e dalë nga mbledhja e Këshillit të Ministrave të datës, 13.8.2008 dhe ajo e datës 24.9.2008

Projektvedimi u dërgua për mendim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave dhe Agjencinë e Prokurimit Publik.

Agjencia e Prokurimit Publik është shprehur parimisht dakort me projektin, duke sugjeruar gjithashtu ndryshimin e disa termave të përdoruar në projekt. Ne mendojmë se terminologjia e përdorur është në koherencë me përmbajtjen e rregullores dhe për këtë arsye sugjerimi nuk është reflektuar.

Në lidhje me mendimet e Ministrisë së Drejtësisë shprehemi se sugjerimet e dhëna përvec pikës I.2 janë reflektuar. Në lidhje me pikën I.2 e gjujkojmë shumë të domosdoshme që Bordi i Modernizimit, të funksionojë në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave i cili përcakton kompetencat konkrete të këtij bordi. Edhe deri tani ky bord ka funksionuar në zbatim të Vendimit nr. 521 datë 8.8.2007 të Këshillit të Ministrave. Ky është një nga Bordet kryesorë në Forcat e Armatosura, vendimarrja e të cilit është në nivelin strategjik. Kjo vendimarrje duhet të jetë e mbështetur nga ana ligjore në këtë vendim i cili përcakton kompetencat kryesore të tij. Përsa i përket mendimeve të Ministrisë së Financave të dërguara me shkresën nr. 9344/2 datë 6.10.2008 shprehemi se përveç sugjerimit të

parë dhe të dytë të gjitha të tjerat janë marrë parasysh duke bërë rregullimet përkatëse.

Në lidhje me sugjerimin e parë shprehemi se ishte vetë Këshilli i Ministrave që në mbledhjen e datës 13.8.2008 dhe atë të datës 24.9.2008 vendosi që këto procedura të miratohen nga qeveria dhe jo nga Ministria e Mbrojtjes. Nga Ministria e Mbrojtjes u dërgua varianti që bënte ndryshimet përkatëse me qëllim lejimin e Ministrisë së Mbrojtjes të miratonte këto procedura por nga Këshilli i Ministrave nuk u lejua kjo gjë. Gjithashtu edhe Ministria e Drejtësisë është shprehur në favor të varianit të miratimit të këtyre rregullave nga ana e Këshillit të Ministrave.

Përsa i përket sugjerimit të dytë, ne gjykojmë se është e domosdoshme të qëndrojmë termi sistem pasi ky term nënkupton tërësinë e armëve municioneve e materialeve që lidhen në një njësi të integruar. Një bashkëveprim armësh përbën sistem dhe ai nuk mund të blihet i vecantë dhe i pa inkorporuar në bashkëveprim të njëri tjetrit, pasi arma si e tillë do të humbiste të gjitha vlerat e saj ushtarake.

Projektvendimi i paraqitur shmang në mënyrë të dukshme mungesën e procedurave të nevojshme të prokurimit për këto mallra e shërbime, duke evituar abuzimet e mundshëm për blerje të tilla. Ky projektvendim çon më tej angazhimet e marra për luftën kundër korrupsionit, duke bërë të mundur aplikimin e rregullave të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

MINISTRI I MBROJTJES

GAZMEND OKETA



NR.PROT.4234/1
DATË 27.10.2008

PRESIDENCËS
KUVENDIT
MINISTRISË SË MBROJTJES
MINISTRISË SË FINANCAVE
MINISTRISË SË DREJTËSISË

